



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.172

22 dhjetor

2010

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.947, datë 21.10.2010	Për kryerjen e anketimit dhe të regjistrimit të përfituesve të ndihmës ekonomike	8835
Vendim i KM nr.949, datë 24.11.2010	Për miratimin, në parim, të dokumentit ndryshues të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e transportit	8836
Vendim i KM nr.950, datë 24.11.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të z.Bardhyl Lleshi, në Pakistan	8836
Vendim i KM nr.951, datë 24.11.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të shtetases Jorgjie Meko, në Turqi	8837
Vendim i KM nr.955, datë 24.11.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i shëtitorës së Orikutit “Faza III”, në bashkinë e Orikutit	8837
Vendim i KM nr.956, datë 24.11.2010	Për kalimin në pronësi të bashkisë së Shkodrës të pronës nr.373 “Ish-grup artilerie”, në Tepe, Shkodër, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”	8838

Vendim i KM nr.961, datë 24.11.2010	Për përcaktimin e Autoritetit Rregullator Koordinues të Bazave të të Dhënave Shtetërore	8839
Vendim i KM nr.964, datë 24.11.2010	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 27.5.2010, për çështjen nr.847/05 “Berhani kundër Shqipërisë”	8839
Vendim i KM nr.967, datë 2.12.2010	Për një ndryshim në vendimin nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar	8840
Vendim i KM nr.1014, datë 15.12.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.989, datë 9.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e përdorimit të fondit të emergjencave civile në qarkun e Shkodrës, për të përballuar situatën e shkaktuar nga përmbytjet natyrore”	8840
Udhëzim i MF nr.40, datë 3.12.2010	Për një shtesë në udhëzimin nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat”, të ndryshuar	8841
Udhëzim i METE nr.873, datë 13.12.2010	Për përcaktimin e kriterëve për shtyrjen e afateve të përgatitjes së projekteve të zbatimit dhe marrjes së lejeve në kontratat koncesionare të miratuara	8842
Vendim i KKRT nr.193, datë 12.11.2010	Për rinovimin e licencës së subjektit “Planet Televizion” sh.a. për subjektin televiziv privat vendor “Tv Planet” ...	8843
Vendim i KKRT nr.194, datë 12.11.2010	Për dhënie licence për televizionin privat vendor “Tv Real” subjektit “Rtv-Real” sh.p.k.	8843
Vendim i KKRT nr.195, datë 12.11.2010	Për dhënie licence për televizionin privat vendor “Tv Star Plus” subjektit “Star Plus” sh.p.k.	8844
Vendim i ERE nr.91, datë 30.11.2010	Për dhënien e statusit të klientit të kualifikuar subjektit “Colacem Albania sh.p.k.”	8844
Vendim i ERE nr.92, datë 30.11.2010	Për dhënien e statusit të klientit të kualifikuar subjektit “City Park”	8845
Vendim i ERE nr.93, datë 30.11.2010	Për miratimin e programit të uljes së humbjeve totale për tri periudhat e rregullimit	8846
Vendim i ERE nr.94, datë 1.12.2010	Për ankimin e “CEZ shpërndarje” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.90, datë 15.11.2010	8846
Vendim i ERE nr.95, datë 7.12.2010	Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për periudhën 1 janar–31 dhjetor 2011	8847
Vendim i ERE nr.96, datë 7.12.2010	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “Tec Vlorë” sh.a. te furnizuesi publik me shumicë për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2011.....	8848

Vendim i ERE nr.97, datë 7.12.2010	Për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën 1 janar–31 dhjetor 2011.....	8848
Vendim i ERE nr.98, datë 7.12.2010	Për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2011.....	8849
Vendim i ERE nr.99, datë 7.12.2010	Për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike nga “CEZ shpërndarja” sh.a. për periudhën 1 janar–31 dhjetor 2011.....	8849
Vendim i ERE nr.100, datë 7.12.2010	Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën 1 janar–31 dhjetor 2011.....	8850
Vendim i ERE nr.101, datë 7.12.2010	Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e reja me fuqi të instaluar deri në 15 MW për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2011	8852
Vendim i ERE nr.102, datë 7.12.2010	Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2011.....	8852
Vendim i ERRU nr.20, datë 26.4.2010	Për licencim për herë të parë të operatorit Ujësjellës sh.a. Selenicë	8853
Vendim i ERRU nr.21, datë 6.5.2010	Për rinovim licence të operatorit për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik Ujësjellës Kanalizime sh.a. Rrogozhinë	8853
Vendim i ERRU nr.22, datë 6.5.2010	Për rinovim licence të operatorit Ujësjellës Kanalizime sh.a. Gjirokastër (qytet)	8854
Vendim i ERRU nr.23, datë 4.6.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Ujësjellës Kanalizime sh.a. Gjirokastër (qytet)	8854
Vendim i ERRU nr.24, datë 4.6.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Ujësjellës sh.a. Elbasan (fshat)	8855
Vendim i ERRU nr.25, datë 4.6.2010	Për licencim për herë të parë të operatorit Ndërmarrja e Ujësjellësit sh.a. Gjirokastër (fshat)	8856
Vendim i ERRU nr.26, datë 18.6.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Ujësjellës Kanalizime sh.a. Rrogozhinë	8856
Vendim i ERRU nr.27, datë 18.6.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Ujësjellës sh.a. Poliçan	8857
Vendim i ERRU nr.28, datë 30.6.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Ujësjellës Kanalizime sh.a. Sarandë	8857

Vendim i ERRU nr.29, datë 30.6.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Kavajë	8858
Vendim i ERRU nr.30, datë 12.7.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Ujësjetllës sh.a. Selenicë	8858
Vendim i ERRU nr.31, datë 12.7.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Ujësjetllës sh.a. Gjirokastër (fshat)	8859
Vendim i ERRU nr.33, datë 15.7.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Durrës	8859
Vendim i ERRU nr.34, datë 19.7.2010	Për rinovim licence të operatorit Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Shkodër (qytet)	8860
Vendim i ERRU nr.35, datë 23.7.2010	Për licencim për herë të parë të operatorit Ujësjetllës sh.a. Novoselë	8860
Vendim i ERRU nr.40, datë 30.7.2010	Për rinovim licence të operatorit Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Durrës	8861
Vendim i ERRU nr.41, datë 30.7.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Shkodër	8861
Vendim i ERRU nr.42, datë 30.7.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Ujësjetllës sh.a. Tepelenë	8862
Vendim i ERRU nr.43, datë 30.7.2010	Për miratimin e tarifave të ujit për konsum publik për Ujësjetllës sh.a. Peqin	8862
Vendim i ERRU nr.46, datë 11.10.2010	Për licencimin të operatorit për herë të parë Ndërmarrja e Ujësjetllës sh.a. Shkodër (fshat)	8863
Vendim i ERRU nr.47, datë 11.10.2010	Për rinovim licence të operatorit për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor dhe drejtuesit teknik të Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Lushnjë	8863
Vendim i ERRU nr.48, datë 15.10.2010	Për rinovim licence Ujësjetllës sh.a. Kurbin	8864
Kërkesë e MPPT nr.607/4, datë 19.11.2010	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Dalja Ura e Vashës-Bulqizë”	8864

VENDIM
Nr.947, datë 21.10.2010

PËR KRYERJEN E ANKETIMIT DHE TË REGJISTRIMIT TË PËRFITUESVE TË NDIHMËS EKONOMIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 44 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryerjen e anketimit dhe të regjistrimit të përfituesve të ndihmës ekonomike, me fondin prej 83 751 000 (tetëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë) lekësh, sipas preventivit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Instituti i Statistikës ngarkohet të kryejë anketimin dhe regjistrimin e përfituesve të ndihmës ekonomike, për llogari të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si dhe të kryejë të gjitha procedurat administrative për kryerjen e këtij procesi.

3. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të kryejë të gjitha pagesat, në përputhje me fondet e miratuara dhe me dokumentacionin e paraqitur nga Instituti i Statistikave.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2010 për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në programin “Mbrotjtja sociale”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Në 2010-Buxheti përfundimtar

Nr.	Zërat	Përshkrimi	Njësitë	Lekë/njësi	Lekë	Shuma gjithsej
1	Printimi i pyetësorëve dhe manualeve					
1.1	Pyetësorët dhe manualët e instruksioneve për anketues dhe supervizorë	98 000 pyetësorë (22 faqe)	2 156 000	8	17 280 000	17 280 000
2	Trajnimi i anketuesve dhe supervizorëve					
2.1	Akomodim i plotë	5 ditë x 557 persona x 5 500 lekë/ditë	2 785	5 500	15 314 000	15 314 000
2.2	Akomodim i pjesshëm	5 ditë x 109 persona x 1000	545	1 000	545 000	545 000
2.3	Pushim kafeje	(691 persona x 120 lekë)* 5	3 455	120	400 000	400 000
2.4	Sallë konference (5 ditë) për 6 trajnime	(5 ditë x 25000 lekë/ditë)*6	30	25 000	700 000	700 000
3	Mbledhja e të dhënave					
3.1	Pagesa e anketuesve	97 200 pyetësorë x 400 lekë/pyetësori	97 200	400	38 880 000	38 880 000
3.2	Dieta dhe transporti i anketuesve në zonat rurale	400 anketues x 1 muaj x 12 000 lekë/muaj	400	12 000	4 800 000	4 800 000
3.3	Pagesa e supervizorëve	52 supervizorë x 1 muaj x 40 000 lekë/muaj	52	40 000	2 080 000	2 080 000
3.4	Dieta dhe transporti i supervizorëve	52 supervizorë x 1 muaj x 16 500 lekë/muaj	52	16 000	832 000	832 000
3.6	Pagesa për koordinatoret kombëtarë	12 koordinatoret x 1 muaj x 50 000 lekë/muaj	12	50 000	600 000	600 000
4	Kontrolli dhe skanimi i pyetësorëve					
4.1	Operatorë kontrollorë për skanimin	60 persona x 1 muaj x 27 000 lekë/muaj	60	27 000	1 620 000	1 620 000
6	Mallra konsumi					
6.1	Mallra konsumi	Kancelari			700 000	700 000
					Gjithsej lekë	83 751 000

Shënim. Gjashtë trajnimet do të zhvillohen në rrethet: Tiranë, Kukës, Shkodër, Elbasan, Fier dhe Dibër.

Paga e një supervizori do të jetë e barabartë me kategorinë: specialist 4a, pa sigurim shoqëror.

Paga e një koordinatori do të jetë e barabartë me kategorinë: Përgjegjës sektori 3a, pa sigurim shoqëror.

Paga e një operatori do të jetë e barabartë me kategorinë VI, pa sigurim shoqëror.

83751 000

64671 000

VENDIM
Nr.949, datë 24.11.2010

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË DOKUMENTIT NDRYSHUES TË MARRËVESHJES SË
FINANCIMIT, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR
ZHVILLIM (IDA), PËR PROJEKTIN E TRANSPORTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin në parim të dokumentit ndryshues të Marrëveshjes së financimit, ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), për projektin e transportit.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.950, datë 24.11.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z.BARDHYL
LLESHI, NË PAKISTAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë në buxhetin e miratuar për vitin 2010, në zërin “Mallra dhe shërbime”, i shtohet fondi 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, për përballimin e shpenzimeve të kurimit të z.Bardhyl Lleshi, në Pakistan.
 2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
 3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
 4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.951, datë 24.11.2010

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË SHTETASES
JORGJIE MEKO, NË TURQI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190 datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të shtetases Jorgjie Meko, në Turqi.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.955, datë 24.11.2010

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SHËTITORES SË
ORIKUMIT “FAZA III”, NË BASHKINË E ORIKUMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5/1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i shëtitores së Orikumit “Faza III”, në bashkinë e Orikumit.
2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Orikumit.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, për sipërfaqen prej 50 (pesëdhjetë) m², tokë truall, pronë private, në masën 893 350 (tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Orikumit, planifikuar në buxhetin e saj.
5. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
6. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Orikumit.
7. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Orikumit, për realizimin e këtij projekti.
8. Regjistrimi i ri i pasurisë, 50 (pesëdhjetë) m², tokë truall, shpronësuar në favor të bashkisë së Orikumit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Orikut për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR “NDËRTIMIN E SHËTITORES ORIKUM, FAZA E TRETË” NË BASHKINË E ORIKUMIT

Nr.	Emër, mbiemër	Sipërfaqe truall m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera në lekë	Numri i pasurisë	Zona kadastrale
1	Zyber Kumanaku	50	17 867	893 350	408/183	2832
	Totali	50		893 350		

VENDIM

Nr.956, datë 24.11.2010

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË SHKODRËS TË PRONËS NR.373 “ISH-GRUP ARTILIERIE”, NË TEPE, SHKODËR, NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, shkronja “c”, 3, 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të bashkisë së Shkodrës të pronës nr.373 “Ish-grup artilerie”, në Tepe, Shkodër, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, për ta përdorur për realizimin e programeve mësimore, ndërtim shkollë, objekte sociale, kulturore, sportive dhe të shëndetit publik, në qytetin e Shkodrës.

2. Prona nr.373, me emërtesë “Ish-grup artilerie”, në Tepe, Shkodër, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Bashkisë së Shkodrës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës, të përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë atë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Dorëzimi i kësaj prone të bëhet pas heqjes së materialeve dhe të pajisjeve të Forcave të Armatosura, të cilat janë depozituar në këtë pronë.

5. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm, kryetari i bashkisë së Shkodrës, si dhe Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.961, datë 24.11.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT RREGULLATOR KOORDINUES TË BAZAVE
TË TË DHËNAVE SHTETËRORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 14 të ligjit nr.10 325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti Rregullator Koordinues i Bazave të të Dhënave Shtetërore është Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).
 2. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.964, datë 24.11.2010

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E
NJERIUT, DATË 27.5.2010, PËR ÇËSHTJEN NR.847/05, “BERHANI KUNDËR SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 2.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 27.5.2010, për çështjen nr.847/05 “Berhani kundër Shqipërisë”, në shumën 4 800 (katër mijë e tetëqind) euro, si dhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin, në masën 10 për qind të kësaj shume.
 2. Autoriteti përgjegjës për ekzekutimin e këtij vendimi është Ministria e Financave. Afati përfundimtar për kryerjen e ekzekutimit është data 4.1.2011.
 3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
 4. Shuma e përcaktuar si detyrim, në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, z.Gentian Berhani, dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.
 5. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit, z.Gentian Berhani, të bëhet nga Ministria e Financave pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.
 6. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.967, datë 2.12.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË PROKURIMIT PUBLIK”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet shtesa dhe ndryshimi, si më poshtë vijon:

1. Pas paragrafit të dytë të shkronjës “c” të pikës 2 të kreut III, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Për procedurën e prokurimit “Ndërtim i tunelit në aksin Tiranë-Elbasan”, të llojit punë publike mbi kufirin e lartë monetar, gjuha e përdorur për zhvillimin e procedurës së prokurimit do të jetë gjuha angleze. Për procedurën e prokurimit “Supervizion punimesh, ndërtim tuneli në aksin Tiranë-Elbasan”, të llojit punë publike mbi kufirin e lartë monetar, gjuha e përdorur për zhvillimin e procedurës së prokurimit do të jetë gjuha angleze.”.

2. Pas shkronjës “a” të pikës 1 të kreut III, shtohet paragrafi “a/1”, me këtë përmbajtje:

“a/1. Për procedurën e prokurimit “Ndërtim i tunelit në aksin Tiranë-Elbasan”, kontrata që do të përdoret nga autoriteti kontraktor për zbatimin e punimeve do të bazohet në kontratën tip FIDIC, libri i kuq (Harmonised Edition)”. Për procedurën e prokurimit “Supervizion punimesh, ndërtim tuneli në aksin Tiranë-Elbasan”, termat e referencës dhe kontrata që do të përdoret nga autoriteti kontraktor, të jenë në përputhje me detyrat e supervizorit, të parashikuara në kontratën tip FIDIC, libri i kuq (Harmonised Edition). Kontrata do të hartohet nga autoriteti kontraktor në bashkëpunim me Avokaturën e Shtetit.”.

II. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Agjencia e Prokurimit Publik dhe Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1014, datë 15.12.2010

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.989, DATË 9.12.2010 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E PËRDORIMIT TË
FONDIT TË EMERGJENCAVE CIVILE NË QARKUN E SHKODRËS, PËR TË
PËRBALLUAR SITUATËN E SHKAKTUAR NGA PËRMBYTJET NATYRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile” dhe të vendimit nr.968, datë 1.12.2010 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës civile në komunat dhe bashkitë në qarkun e Shkodrës”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.989, datë 9.12.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - a) Në shkronjën “a” fjalët “...shuma 300 000 000 (treqind milionë) lekë...” zëvendësohen me “...500 000 000 (pesëqind milionë) lekë...”.
 - b) Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) shuma 100 000 000 (njëqind milionë) lekë nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, miratuar për vitin 2010.”.
2. Në fund të pikës 4 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Shpenzimet regjistruhen nga dega e thesarit në programin “Emergjencat civile” të Ministrisë së Brendshme, në kapitullin 6 (Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit) dhe në klasifikimin ekonomik përkatës, në emër të institucionit të prefekturës.”.
3. Pas pikës 5 shtohet pika 6, me këtë përmbajtje:

“6. Vendimi nr.971, datë 1.12.2010 i Këshillit të Ministrave “Për dhënie fondi për përballimin e situatës emergjente të krijuar në qarkun e Shkodrës, si pasojë e përmytjeve natyrore”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.40, datë 3.12.2010

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 “PËR AKCIZAT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pjesën XIII “Depozitat e karburantit”, pas pikës 54.1 “Naftësjellësit” shtohet pika 54.2 me këtë përmbajtje:

“54.2. Në rast se nafta bruto nuk eksportohet, apo nuk shitet:

 - a) te rafineritë e naftës në vend, apo
 - b) te shoqëritë e tregimit me shumicë, që ushtrojnë veprimtarinë e tregimit me shumicë sipas ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, atëherë kjo naftë bruto do të konsiderohet si “zëvendësues i lëndëve djegëse”, sipas nenit 38 të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002”. të ndryshuar, dhe mbi të do të aplikohet tarifa tatimore e akcizës në masën 50 lekë/litri.

Si provë e tregimit të naftës bruto, sipas paragrafit të parë të kësaj pike, duhet të shërbejnë kontratat e shitjes me rafineritë, për eksport dhe me shoqëritë e tregimit me shumicë.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM
Nr.873, datë 13.12.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR SHTYRJEN E AFATEVE TË PËRGATITJES SË
PROJEKTEVE TË ZBATIMIT DHE MARRJES SË LEJEVE NË KONTRATAT
KONCESIONARE TË MIRATUARA**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të pikës 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.448, datë 16.6.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Shoqëritë koncesionare, të cilat deri në momentin e hyrjes në fuqi të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.448, datë 16.6.2010, nuk kanë të parashikuar afatin e nevojshëm për përgatitjen e projektit të zbatimit dhe për marrjen e lejeve në kontratat koncesionare të miratuara, kanë të drejtë të përfitojnë afate shtesë, sipas përcaktimeve në pikën 1 të vendimit të Këshillit të Ministrave të mësipërm.

2. Shoqëritë koncesionare, që kërkojnë shtyrjen e afateve si më sipër, duhet të paraqesin zyrtarisht pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) kërkesën për shtyrjen e afateve.

3. Kërkesa e shoqërisë koncesionare përcillet për shqyrtim në Drejtorinë e Përgjithshme të Projekteve dhe Bashkëpunimit Ekonomik. Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, vlerësojnë dhe shqyrtojnë kërkesën.

a) Kërkesa do të trajtohet duke u mbështetur mbi kontratën përkatëse të koncesionit dhe aneksin bashkëlidhur “Grafiku i punimeve”.

4. Vlerësimi do të bazohet duke marrë në konsideratë këto kritere:

a) kohën e ndërtimit dhe kohën për marrjen e lejeve në grafikun e punimeve;

b) kohën e përcaktuar në kontratë për vënien në shfrytëzim të hidrocentralit/eve.

5. Kërkesa për shtyrjen e afateve do të merret në konsideratë për trajtim të mëtejshëm në rastet kur:

a) afatet për marrjen e lejeve nuk janë të parashikuara në grafikun e punimeve dhe/ose në kontratë;

b) afati i parashikuar për marrjen e lejeve, është më i shkurtër se afati i parashikuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.448, datë 16.6.2010, në përputhje me kapacitetin përkatës të hidrocentralit/eve.

6. Kur kërkesa për shtyrjen e afateve është në kushtet e rastit (a) të pikës 5, do të përcaktohen afatet konkrete shtesë, për përgatitjen e projektit dhe marrjen e lejeve, si më poshtë:

a) 12 muaj për kontratat e koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit/eve me fuqi të instaluar deri në 5MW;

b) 18 muaj për kontratat e koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit/eve me fuqi të instaluar nga 5MW deri në 20 MW;

c) 24 muaj për kontratat e koncesionit për ndërtimin e hidrocentralit/eve me fuqi të instaluar mbi 20 MW.

7. Kur kërkesa për shtyrjen e afateve është në kushtet e rastit (b) të pikës 5, afati shtesë do të jetë sa diferenca ndërmjet afatit të parashikuar për marrjen e lejeve sipas kontratës dhe afatit të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.448, datë 16.6.2010, në përputhje me kapacitetin përkatës të hidrocentralit/eve.

8. Afatet shtesë do të përlojariten duke filluar nga përfundimi i afatit të përcaktuar në kontratën e koncesionit për vënien në shfrytëzim të hidrocentralit/eve.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve dhe Bashkëpunimit Ekonomik, në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Juridike, përgatitin informacionin e nevojshëm mbi procedurën e ndjekur për trajtimin e kërkesës dhe e përcjellin për miratim te titullari i autoritetit kontraktor, së bashku me kontratën shtesë për shtyrjen e afateve, e cila do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga palët.

10. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Projekteve dhe Bashkëpunimit Ekonomik dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Illir Meta

VENDIM
Nr.193, datë 12.11.2010

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT “PLANET TELEVISION” SHA PËR
SUBJEKTIN TELEVIZIV PRIVAT VENDOR “TV PLANET”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca e subjektit “Planet Television” sh.a., për subjektin televiziv privat vendor “TV Planet”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
 2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 9.11.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.194, datë 12.11.2010

**PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT VENDOR “TV REAL”
SUBJEKTIT: “RTV-REAL” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.98, datë 24.9.2010 “Për organizimin e konkurrimit të kandidatave për operatorë privatë televizivë analogë vendorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Rtv-Real” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për të mbuluar me sinjal qytetin e Vlorës.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.195, datë 12.11.2010

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT VENDOR “TV STAR PLUS”
SUBJEKTIT: “STAR PLUS” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, si dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.98, datë 24.9.2010 “Për organizimin e konkurrimit të kandidatave për operatorë privatë televizivë analogë vendorë”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Star-Plus” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, për të mbuluar me sinjal rrethin e Shkodrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.91, datë 30.11.2010

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR SUBJEKTIT
“COLACEM ALBANIA SHPK”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5 pika 2 të rregullores “Për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006 dhe ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.17, datë 6.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.11.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga subjekti “Colacem Albania sh.p.k.” për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kërkesat e rregullores “Për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar” dhe vendimit nr.8, datë 29.1.2010 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar për vitin 2010” si më poshtë:

- Neni 4 germa “a” është plotësuar konform rregullores.
- Neni 4 germa “b” është plotësuar konform rregullores.
- Neni 4 germa “c” është plotësuar konform rregullores.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e statusit të klientit të kualifikuar subjektit “Colacem Albania sh.p.k.”.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.92, datë 30.11.2010

PËR DHËNIEN E STATUSIT TË KLIENTIT TË KUALIFIKUAR SUBJEKTIT
“CITY PARK”

Në mbështetje të neneve 9 dhe 48 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5 pika 2 të rregullores “Për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.99, datë 27.12.2006 dhe ndryshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.17, datë 6.3.2009 Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.11.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga subjekti “City Park” për marrjen e statusit të klientit të kualifikuar, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatoi se:

Aplikimi plotëson kërkesat e rregullores “Për kriteret e dhënies dhe heqjes së statusit të klientit të kualifikuar” dhe vendimit nr.8, datë 29.1.2010 të Bordit të Komisionerëve “Për miratimin e nivelit të konsumit vjetor të energjisë elektrike për përfitimin e statusit të klientit të kualifikuar për vitin 2010” si më poshtë:

- Neni 4 germa “a” është plotësuar konform rregullores.
- Neni 4 germa “b” është plotësuar konform rregullores.
- Neni 4 germa ”c” është plotësuar konform rregullores.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënie e statusit të klientit të kualifikuar subjektit “City Park”.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.93, datë 30.11.2010

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË ULJES SË HUMBJEVE TOTALE PËR TRI PERIUDHAT E RREGULLIMIT

Në mbështetje të nenin 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të pikës 4.5 të deklaratës rregullatore, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.12, datë 3.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.11.2010, pasi analizoi propozimin e riskedulimit të programit të uljes së humbjeve totale të propozuar nga “CEZ shpërndarje” sh.a. dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

VENDOSI:

1. Të miratojë programin e uljes së humbjeve për të tria periudhat e rregullimit sipas skedulit të mëposhtëm:

- 6% ulje kumulative për periudhën e parë të rregullimit 1 janar – 31 dhjetor 2010 dhe për periudhën e dytë të rregullimit 1 janar - 31 dhjetor 2011.

- 11% ulje për periudhën e tretë të rregullimit 1 janar 2012 – 31 dhjetor 2014, në përputhje me planin e investimeve që do të miratohet për kompaninë nga ERE për periudhën përkatëse.

2. Ngarkohet “CEZ shpërndarje” për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.94, datë 1.12.2010

PËR ANKIMIN E “CEZ SHPËRNDARJE” SHA PËR VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR.90, DATË 15.11.2010

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative” të nenit 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, të miratuara me vendimin nr.18 datë 21.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 1.12.2010, pasi analizoi kërkesën e “CEZ shpërndarje” sh.a. për ankimin e vendimit nr.90, datë 15.11.2010 dhe relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për këtë çështje,

Konstaton se:

- “CEZ shpërndarje” sh.a. në kërkesën e saj të datës 19.11.2010, ka riformuluar të njëjtat argumente që ka paraqitur edhe gjatë zhvillimit të mbledhjes së Bordit të Komisionerëve të datës 15.11.2010.

- Nuk është paraqitur asnjë dokumentacioni i ri provues, siç përcaktohet në nenin 16 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s lidhur me praktikën për vendosjen e dëmit ekonomik.

Sipas kompanisë emërtimi “energji e pamatur” i aplikuar nga “CEZ shpërndarje” kryhet edhe në referencë të pikës IV.9 të Kodit të Matjes.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos marrë parasysh pretendimet e “CEZ shpërndarje”, të paraqitura në ankesën e “CEZ shpërndarje”, datë 18.11.2010 dhe 23.11.2010, për pikën 1 të vendimit, nr.90, datë 15.11.2010, duke lënë në fuqi pikën 1 të vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE nr.90, datë 15.11.2010 “Për dënimin

me gjobë të “CEZ shpërndarje” sh.a. për shkeljet e konstatuara lidhur me moszbatimin nga ana e saj të vendimeve të ERE-s”.

2. Në pikën 2 të vendimit nr.90, datë 15.11.2010, bëhet një ndryshim, duke shtuar pas fjalëve “energji e pamatur” shprehjen si më poshtë:

“Për ato raste kur nuk aplikohet në zbatim të zbatimit të pikës IV.9 të Kodit të Matjes”.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë “CEZ shpërndarje” sh.a. për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Bujar Nepravishta**

**VENDIM
Nr.95, datë 7.12.2010**

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
KESH SHA PËR PERIUdhËN 1 JANAR - 31 DHJETOR 2011**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “b”, 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, vendimit nr.62, datë 13.9.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2011, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për vitin 2011, si dhe relacionin e grupit të punës të ERE-s,

VENDOSI:

1. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2011 do të jetë 0.63 lekë/kWh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI
Bujar Nepravishta**

VENDIM
Nr.96, datë 7.12.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA TEC VLORË SHA TE FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË PËR
PERIUdhËN 1 JANAR - 31 DHJETOR 2011**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të vendimit nr.77, datë 26.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e “Tec Vlora” sh.a., si dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga “Tec Vlora” sh.a. te furnizuesi publik me shumicë, për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2011 do të jetë kosto fikse vjetore 1,341,482 mijë lekë/vit dhe kosto variabël 16 lekë/kWh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “Tec Vlorë” sh.a. dhe KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.97, datë 7.12.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR FURNIZUESIN PUBLIK
ME SHUMICË PËR PERIUdhËN 1 JANAR - 31 DHJETOR 2011**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “b”, 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.78, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, të vendimit nr.63, datë 13.9.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2011”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2011, si dhe relacionin e grupit të punës të ERE-s,

VENDOSI:

1. Tarifa e energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2011 do të jetë 1.48 lekë/kWh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.98, datë 7.12.2010

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA OST SHA PËR PERIUdhËN 1 JANAR - 31 DHJETOR 2011

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “b”, 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.59, datë 29.12.2005 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, vendimit nr.64 datë 13.9.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2011”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. për përcaktimin e tarifës të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2011, si dhe relacionin e grupit të punës të ERE-s,

VENDOSI:

1. Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2011 do të jetë 0.60 lekë/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.99, datë 7.12.2010

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
“CEZ SHPËRNDARJA SHA” PËR PERIUdhËN 1 JANAR – 31 DHJETOR 2011

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “b”, 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.79, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, vendimin nr.65, datë 13.9.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike nga “CEZ shpërndarja” sh.a. për vitin 2011”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e “CEZ shpërndarja” sh.a. për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2011, si dhe relacionin e grupit të punës të ERE-s,

VENDOSI:

1. Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike për “CEZ shpërndarja” sh.a. për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2011 do të jetë 6,30 lekë/kWh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e “CEZ shpërndarja” sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.100, datë 7.12.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR KONSUMATORËT TARIFORË PËR PERIUHDHËN 1 JANAR – 31 DHJETOR 2011**

